

fq. 2**Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2014**

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare për periudhën janar-mars 2014 *fq. 3-4*
- » Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve për periudhën janar-mars 2014 *fq. 4*

ZHVILLIME TË TJERA

- » Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s *(27-28 maj, Jeruzalem, Izrael)* *fq. 5*
- » Seminar për mbikëqyrjen me bazë risku *(27-28 maj, Lubljanë, Slloveni)* *fq. 5-7*

LAJMET NGA RAJONI

- » Maqedoni » Serbi » Sllovaki *fq. 7-8*

STUDIME DHE BOTIME

- » "Vështrim mbi ekonominë" nga OECD *fq. 9*
- » "Zbatimi i kuadrit rregullator dhe inspektimet" nga OECD

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 26.01% gjatë periudhës janar-prill 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 3.50 miliardë lekë. Kjo u shoqërua edhe me ulje të numrit të policave të sigurimit me rreth 8.79% duke arritur në 252,399 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut janë dëmet e paguara bruto. Gjatë periudhës janar-prill 2014 dëmet e paguara bruto u ulën me 1.30% në krahasim me periudhën janar-prill 2013. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.67 miliardë lekë, apo 80.90% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

SIGURIMI I JO-JETËS

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 28.40% gjatë periudhës janar-prill 2014, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

SIGURIMI I DETYRUESHËM MOTORIK

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 1.82 miliardë lekë gjatë periudhës janar-prill 2014, duke shënuar një rritje prej 48.56% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-prill 2014 zuri 52.27% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës.

KLASA TË TJERA NË SIGURIMET E JO-JETËS

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » *Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë*, të cilat zunë 18.31% të tregut të Jo-Jetës;
- » *Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme*, të cilat së bashku zunë 14.07% të tregut të Jo-Jetës.

SIGURIMI I JETËS

Primet e shkruara bruto në Sigurimin e Jetës u rritën me 6.63% krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” dhe përbën 52.20% të sigurimit të Jetës.

NDARJA E TREGUT TË SIGURIMEVE, JANAR-PRILL 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare për periudhën janar-mars 2014

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.03.2014 tregon një total asetesh nën menaxhim prej 485.17 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 49.14 milionë lekë (11.27%). E shprehur në euro (sipas kursit zyrtar të këmbimit më 31.03.2014 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 140.27 lekë, www.bankofalbania.org) totali i aseteve nën menaxhim është 3.46 milionë euro.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.03.2014 ishte 8,191 anëtarë duke shënuar rritje prej 3.85% krahasuar me fundin e vitit 2013.

Tregues të fondeve të pensioneve

(31.03.2014)


Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
	2013	T I-2014	
Asetet neto të FP	434.82	483.54	11.20

Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve

(31.03.2014)


Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	Asete Neto (mln. lekë)
SIGAL	3,737	224.27
RAIFFEISEN	2,577	193.33
SICRED PENSION	1,877	65.94
TOTAL	8,191	483.54

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 31.03.2014 (në %)



Primet e sigurimit të
miliardë lekë gjatë
krahasuar me të një

Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 31.03.2014 (në %)



Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve për periudhën janar-mars 2014

Gjatë periudhës janar-mars 2014, në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigi” dhe Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro”.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve në 31.03.2014, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 59.45 miliardë lekë me një rritje prej 18.12% krahasuar me 31.12.2013.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare të cilët përbëjnë 80.89% të aseteve të fondeve, me rritje prej 13.92% krahasuar me 31.12.2013.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 31.03.2014 ishte 32,597.

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*) në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Letrave me Vlerë të Izraelit (*Israel Securities Authority, ISA*) zhvilluan në datat 27-28 maj 2014 në Jeruzalem, Izrael, mbledhjen e radhës të Komitetit Evropian të IOSCO-s (*ERC Meeting*). Komiteti Evropian është njëri nga katër komitetet e specializuara sipas rajoneve që mbledhen rregullisht për të diskutuar për problemet rajonale. AMF është anëtare e këtij komiteti.

Në takimin e majit u diskutua për një grup tematikash që lidhen me riskun dhe pasojat e mundshme të politikave, tregun e obligacioneve të shoqërive tregtare, analizën mbi risqet e ndryshme që po shfaqen në tregjet në zhvillim në situatën e tanishme si dhe perspektivat, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, hyrja e tyre në tregun e kapitaleve dhe përdorimi i instrumenteve të tregut të kapitaleve, etj. Gjithashtu, gjatë mbledhjes u shkëmbyen ide lidhur me drejtimit e reja të zhvillimit për çështje të bashkëpunimit ndërkufitar dhe qeverisjes së korporatave.

Disa anëtarë të Komitetit Evropian paraqitën përditësimet rregullative dhe prezantime për zhvillimet aktuale. Kështu prezantime u bënë nga kryetari i ISA-së së Izraelit, përfaqësuesi i CONSOB Itali, përfaqësuesi i FCA-së së Anglisë si dhe Zv. Guvernatori i Parë i Bankës së Ruisë.

Një vëmendje e veçantë në takim ju kushtua edhe çështjeve organizative dhe politikave strategjike të Komitetit Evropian siç ishin ato për procesin e zgjedhjes së kryetarit dhe nënkryetarit të ERC-së për mandatin 2014-2016, zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, si dhe çështjeve të politikave kundër krimit kibernetik.

Në mbledhje u diskutuan edhe çështjet organizative lidhur me procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve multilaterale të bashkëpunimit prej disa autoriteteve anëtare të IOSCO-s.

Seminar për mbikëqyrjen me bazë risku

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Fondeve të Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*) në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Agjencinë Sllovene të Mbikëqyrjes në Sigurime (*AZN*) organizuan më 27-28 maj, në Lubljanë, Slloveni seminarin rajonal me temë "Mbikëqyrja me Bazë Risku".

Programi i seminarit synonte njohjen sa më të plotë të pjesëmarrësve me mbikëqyrjen me bazë risku, e cila përdoret nga disa autoritete mbikëqyrëse dhe që në vazhdimësi do të jetë një kërkesë për Solvency II. Lektorë të seminarit ishin ekspertë nga EIOPA, Banka Botërore, Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë (*FMA*), Autoriteti Mbikëqyrës e Rregullator i Mbretërisë së Bashkuar (*PRA*) dhe Autoritetit Mbikëqyrës i Polonisë (*KNF*).

Në seminar u prezantuan përvojat e mbikëqyrësve të ndryshëm, duke u fokusuar në aspekte të procesit mbikëqyrjes si: vlerësimi i riskut dhe menaxhimi i tij, vlerësimi vetjak i riskut dhe i aftësisë paguese (*Own Risk & Solvency Assessment, ORSA*), struktura e rregullatorit nën qasjen e riskut (*Risk Based Supervision, RBS*), sjellja e tregut dhe çështjet e qeverisjes së shoqërive. U theksua nevoja për të forcuar sistemet e menaxhimit të riskut të siguruesve, kryerjen e kontrolleve parandaluese nëpërmjet sistemeve të paralajmërimit të hershëm (*Early Warning System*), sistemet e Teknologjisë së Informacionit për mbledhjen e të dhënave dhe vlerësimin e rrezikut, inspektimet rregullatore tematike dhe jo të përgjithshme, përdorimi i testeve të ndjeshmërisë, vlerësimi vetjak i riskut dhe aftësisë paguese, *ORSA*, etj.

Vëmendje e veçantë ju kushtua edhe mbikëqyrjes së grupeve të sigurimit dhe ekzistencës së kolegjeve rregullatore. Shembujt u bazuan në grupet austriake të sigurimit, të cilat janë të pranishme edhe në Shqipëri. Kështu u paraqitën tre modele të vlerësimit të rrezikut në grup, të cilat identifikuan nëntë rreziqe kryesore:

- » Riskun makroekonomik (densiteti dhe penetrimi i sigurimeve, GDP, inflacioni, *credit rating*);
- » Riskun e kreditit;
- » Riskun nga investimet (risiku për aktivet, nga normat e ulëta të interesit dhe përputhshmëria e aktiveve me detyrimet);
- » Riskun e likuiditetit;
- » Riskun e përfitueshmërisë dhe aftësisë paguese (*profitability and solvency risk*);
- » Riskun ligjor (lehtësirat fiskale, çështjet në gjykata, etj);
- » Riskun e portofolit të sigurimeve (densiteti dhe penetrimi i sigurimeve, rritja e të ardhurave nga primet e shkruara bruto);
- » Riskun e qeverisjes së shoqërisë (efikasiteti i kontrollit të brendshëm);
- » Riskun nga ndërlidhjet në grup (*contagion risk*).

Gjithashtu u prezantua modeli i vlerësimit të riskut nga ekspertët e Autoritetit Mbikëqyrës e Rregullator të Mbretërisë së Bashkuar, *PRA*. Përveç rreziqeve përmendur sa më sipër, treguesit kryesore të këtij modeli ishin:

- » Krahasimi i treguesit të kthimit mbi kapitalin ROE me koston e kapitalit;
- » Diversifikimi i burimit të të ardhurave;
- » Lulatja e rezultateve financiare.

Përfaqësuesi nga Autoriteti Mbikëqyrës në Poloni prezantoi sistemin mbikëqyrës aktual dhe kuadrin e vlerësimit të riskut. Sipas këtij kuadri, tre blloqet kryesore për vlerësimin e riskut të siguruesit ishin:

- » Mjaftueshmëria e Kapitalit (30%);
- » Efikasiteti i qeverisjes dhe menaxhimit të lartë (50%);
- » Rreziku i tregut, kreditit dhe i sigurimeve (30%).

Programi kishte të ndërthurur seancat teknike e teorike, si dhe u dha mundësinë pjesëmarrësve të ballafaqonin eksperiencat dhe sfidat me të cilat ata përballen gjatë proceseve mbikëqyrëse.

LAJMET NGA RAJONI

MAQEDONI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të siguruar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, ky treg arriti në 7.19 miliardë MKD (monedha maqedonase-dinarë-afërsisht 117 milionë euro) në fund të dhjetorit 2013, ose 2.6% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në lidhje me llogarinë fitim-humbje, Z. Klime Poposki, President i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA) deklaroi për XPRIMM: "... Pas dy vjet humbesh në nivel industrial, në vitin 2013 sektori i sigurimeve arriti fitime në vlerën prej 211.70 milionë dinarë (afërsisht 3.44 milionë euro)".

Nga linjat e biznesit të madh, pjesa e sigurimeve të Jo-Jetës në totalin e primeve ka qenë 89.86% ndërsa pjesa e primit të sigurimit të Jetës afërsisht 10.14%, duke qenë "hera e parë në historinë e sektorit të sigurimeve në Republikën e Maqedonisë që sigurimi i Jetës tejkaloi pragun e 10% të totalit të volumit të primeve të shkruar bruto të industrisë së sigurimeve", theksoi Z. Poposki.

Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës arritën në 6.41 miliardë dinarë (afërsisht 104 milionë euro), 0.79% më shumë në krahasim me muajin dhjetor 2012, ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës kapën vlerën prej 729 milionë dinarë (afërsisht 119 mijë euro), të cilat tregojnë një nga normat më të larta të rritjes midis vendeve të Evropës Juglindore, 21.96 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

"Rritja reale e tregut të sigurimeve është shumë më e lartë, rreth 4.04% në krahasim me vitin e kaluar, nëse matet përmes numrit të policave të shitura. Në vitin 2013 u shitën 1,058,074 polica krahasuar me vitin 2012 kur u shitën 1,418,575 polica. Konkurrenca e lartë midis 11 kompanive të sigurimit të Jo-Jetës çoi në uljen e çmimeve, duke rezultuar në një rritje prej vetëm 0.79 % në primin e shkruar bruto", shtoi Presidenti i ISA-së të Maqedonisë.

SERBI

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve serbe e mbylli vitin 2013 me një prirje pozitive, duke shënuar një rritje 4.2% të volumit të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 64 miliardë RSD (monedha serbe-dinarë-afërsisht 559 milionë euro). Për shkak të një rritje të madhe, prej mbi 18%, sigurimi i Jetës mblodhi pjesën më të madhe të portofolit të tregut, duke arritur në gati 22% të primeve të shkruara bruto. Nga ana tjetër, zhvillimi i sigurimit të Jo-Jetës në vitin 2013 mund të përcaktohet në gjendje stanjacioni.

Përfaqësuesi i Bankës Kombëtare të Serbisë deklaroi për XPRIMM: "... Sektori i sigurimeve ka vazhduar të tregojë elasticitet që nga fillimi i krizës financiare, duke shënuar prirje pozitive gjatë gjithë periudhës, por më poshtë se niveli i para krizës. Faktorët makroekonomikë ndikuan fuqishëm në ecurinë e tregut të sigurimeve, me rritjen e prodhimit të brendshëm bruto dhe normës së papunësisë duke qenë dy faktorët më të fuqishmit që ndikuan". Kështu, në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës sigurimi MTPL dhe primi i sigurimit të pronës u rritën lehtë, me respektivisht 1.25% dhe 1.7 %, ndërsa primi për mbulimin e plotë të sigurimit motorik vazhdoi të ulet duke shënuar një rënie prej 7% të primeve të shkruara bruto.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Viti 2013 ishte një vit i stabilizuar e pa ndryshime të mëdha për tregun e sigurimeve sllovaqe. Tregu vazhdoi rritjen e volumit të biznesit me ritme të ngadalta, me një rritje 2.7% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 2.17 miliardë euro. Megjithatë, duke vërtuar dy segmentet kryesore të tregut të sigurimeve është e qartë se sigurimi i Jetës pati ecuri më të mirë, duke mbyllur vitin me një rritje 5.9 % të primeve, ndërsa në sektorin e Jo-Jetës pothuajse të gjitha linjat kryesore të biznesit regjistruan një rënie të lehtë.

Ivan Podstupka, këshilltar politik për Komunikimin dhe Marrëdhëniet me Publikun i Shoqatës së Sigurimeve Sllovaqe-SLASPO, tha për XPRIMM se: "Krahasuar me vitin e kaluar, sigurimi standard i Jetës ashtu edhe produktet e reja të sigurimit ishin në rritje, ndërsa sigurimet të lidhura me fondet e investimit qëndruan në nivel stanjacioni. Numri i kontratave të lidhura ra, por u rrit volumi i tyre. Biznesi i sigurimit të Jo-Jetës ra me 3.4%, megjithëse pati rritje të numrit të automjeteve të regjistruara. Kjo rënie erdhi për shkak të çmimit të ulët të sigurimit për kontratë. Në linjën e sigurimit të pasurisë, primi i shkruar bruto u rrit me 1%."

STUDIME DHE BOTIME

“Vështrim mbi ekonominë” nga OECD

Organizata Evropiane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) publikoi “Vështrimin mbi Ekonominë” (*Economic Outlook Volume 2014 Issue 10.1787/eco_outlook-v2014-1-en*).

Ky publikim bëhet dy herë në vit nga OECD dhe analizon tendencat kryesore ekonomike dhe perspektivat për dy vitet në vijim. Në këtë botim, një kapitull i veçantë trajton çështjet e perspektivave të rritjes dhe kërkesat financiare në këndvështrimin afatgjatë.

“Zbatimi i kuadrit rregullator dhe inspektimet” nga OECD

OECD ka publikuar raportin mbi praktikën më të mirë për politikën rregullatore.
DOI:10.1787/9789264208117-en

Ky raport jep udhëzime për hartuesit e politikave për përmirësimin e kuadrit rregullator në drejtim të zbatueshmërisë dhe inspektimeve duke ofruar shembuj të praktikave të mira në këtë drejtim.